



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 213, datë 09.10.2024

PËR

**“CAKTIMIN E ZOTIT PETRIT ÇANO, NËPËRMJET PROCEDURËS SË
NGRITJES NË DETYRË, NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 47 pika 6 dhe 52 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 28 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë zotin Petrit Çano në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
2. Zoti Petrit Çano do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër nga data 10.10.2024 – 10.10.2027.
3. Të ndërpritet caktimi i përkohshëm i prokurorit Petrit Çano, si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, miratuar me vendimin nr. 113, datë 09.07.2024.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Petrit Çano, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.


U shpall në Tiranë, sot më 09.10.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË




ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Ledina Riza



ANËTAR
Moisi Duda



ANËTAR
Olger Eminaj



ANËTAR
Erind Gërmenji



ANËTAR
Erind Merkuri

